

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit : **Asfaltimi i rruges kryesore ne fshatin Cernille**

**Numri i prokurimit : 656-25-5890-5-2-1**

Sa i përket tenderit për : **Asfaltimi i rruges kryesore ne fshatin Cernille**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**ARSIMI COMPANY SH.P.K.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Ferizaj**

**Rruga Shaban Viça, Pn.70000**

*(Kodi postar)*

**049-121-021**

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

**Arsim Ahmeti**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**arsimicompanyshpk@gmail.com**

*(Adresa elektronike)*

**10.07.2025**

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

  
*(Nënshkrimi dhe vula)*

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Njoftimi për kontratë : ne e-prokurim 02.07.2025

Kerkesa per ri-shqyrtim 05.07.2025

Vendim mbi kerkesen per ri-shqyrtim 08.07.2025

Hapja e ofertave: 11.07.2025

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po	<input type="checkbox"/>			Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	----	-------------------------------------

Jo ngase kerkesa jone per ri-shqyrtim ka te beje me kriteret e dosjes se tenderit.

##### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>			Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	----	-------------------------------------

Po jemi njoftuar permes platformes elektronike e-prokurim

##### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK-ja
<p>Neni 1 i ligjit te prokurimit publik- qëllimi,</p> <p>Neni 6 i ligjit te prokurimit publik – ekonomiciteti dhe efikasiteti,</p> <p>Neni 7 i ligjit te prokurimit publik-barazia ne trajtim/jo –diskriminim,</p> <p>Neni 28 i ligjit te prokurimit publik- specifikimet teknike,</p> <p>Neni 59 i ligjit te prokurimit publik– Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi</p> <p>Neni 60 i ligjit te prokurimit publik – Kriteret e dhenies,</p> <p>Neni 69 i ligjit te prokurimit publik – aftësia teknike dhe /ose profesionale</p> <p>Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreshjeve</p>

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtrues**



## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne, si operator ekonomik, paraqesim këtë ankesë pranë OSHP-së për shkak të vendosjes së disa kriterëve të paarsyeshme dhe diskriminuese që bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

**Pretendimi Ankimor numer 1: “Cilindër jo vibrues max 13T – min 1 copë”**

### **I. Nuk ekziston "cilindër jo vibrues" për ngjeshjen e asfaltit**

Në praktikën profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare për ndërtim rrugësh (p.sh., EN 12697, ASTM D2041, AASHTO T166, etj.), ngjeshja e shtresës së asfaltit realizohet përmes **cilindrave vibrues** (vibrating rollers), të cilët sigurojnë arritjen e dendësisë dhe qëndrueshmërisë së nevojshme. Cilindrat jo vibrues **nuk përdoren për kompaktim të asfaltit**, përveçse në raste shumë të veçanta dhe joteknike, si mbështjellje finale ose shtresa të ndjeshme (të cilat nuk ekzistojnë në këtë projekt).

Përdorimi i një cilindri jo vibrues në këtë projekt **nuk ka asnjë arsyetim teknik, dhe nuk përputhet me realitetin inxhinierik.**

### **II. Paramasa e tenderit vetë kërkon kompaktim të kontrolluar dhe profesional**

Në përshkrimet e pozicioneve të paramasës, qartë kërkohet:

- **Ngjeshje e nenbazës deri në 30 MN/m<sup>2</sup>** (Pozicioni 2.2 në të dy pjesët e projektit);
- **Ngjeshje e tamponit me 80 MN/m<sup>2</sup>** (Pozicionet 3.2 dhe 3.3 në të dy pjesët);
- **Ngjeshje e asfaltit AB 0-16mm me trashësi 7cm** (Pozicioni 3.4).

Të gjitha këto operacione **kërkojnë përdorimin e një cilindri vibrues**, pasi është mënyra e vetme për të realizuar kompaktimin në përputhje me standardet. Kërkesa për “cilindër jo vibrues” është në **kontradiktë të plotë me vetë specifikimet teknike të projektit, dhe kompromenton seriozisht cilësinë e rrugës që do të ndërtohet.**

### **III. VLERËSIM LIGJOR**

Kërkesa në fjalë përbën një **shkelje serioze të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës**, si më poshtë:

## Neni 7 – Parimet themelore të prokurimit publik

AK ka vendosur një kriter që **nuk bazohet në nevoja reale teknike**, duke e kufizuar konkurrencën dhe duke u shmangur nga standardet teknike objektive.

## Neni 28 – Specifikimet teknike

Specifikimi “cilindër jo vibrues” **nuk është i përshtatshëm për qëllimin e kontratës**, dhe nuk përputhet me standardet teknike ndërkombëtare për asfaltim rrugësh.

## Neni 59 dhe 60 – Përshkrimi i mjeteve dhe pajisjeve

Specifikimi nuk është i qartë, objektiv apo i arsyeshëm. Për më tepër, është **teknikisht i gabuar dhe i pavlefshëm**, duke cenuar besueshmërinë e dokumentacionit të tenderit.

## Neni 69 – Trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë

Përfshirja e makinerive standarde të industrisë siç janë **cilindrat vibrues**, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve që përdorin teknologji moderne dhe në përputhje me standardet. Kjo krijon **favorizim të operatorëve të caktuar apo eliminohet konkurrenca pa arsyetim teknik**.

Në përgjigjen që kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna Ferizaj, argumentohet se kriteri është vendosur duke pasur parasysh “**kushte të veçanta të terrenit**” dhe se operatorët kanë të drejtë të ofrojnë makineri me qira.

Megjithatë, kjo përgjigje është e papranueshme, sepse:

- **Nuk justifikon përdorimin e një pajisjeje të pasaktë teknikisht**, por vetëm e relativizon çështjen me arsyetime të përgjithshme;
- **Nuk ofron asnjë referencë teknike apo standard të ndërtimit që e mbështet përdorimin e cilindrit jo vibrues;**
- **Nuk ka asnjë segment në paramasë që kërkon makineri të tillë, përkundrazi, kërkojnë vlera të larta të ngjeshjes që arrihen vetëm përmes cilindrave vibrues.**

Bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit:

1. **Të konstatojë se kriteri teknik "Cilindër jo vibrues max 13T – min 1 copë" e aq me pak me rexhistrim është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe standardet e ndërtimit;**
2. **Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që ta heqë këtë kriter nga dosja e tenderit dhe të lejojë përdorimin e pajisjeve që përmbushin funksionalitetin real – konkretisht, cilindrave vibrues për asfaltim;**



## **PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2 – MAKINË PËR SHESHIM DHE NIVELIZIM RRUGËSH “MAX 6 TONË”**

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përfshirë kriterin vijues:

**“Makina për sheshim dhe nivelizim të rrugëve max 6 tonë – minimum 1 copë”**

Ky kriter paraqet një problem teknik, profesional, ligjor dhe etik, pasi:

- Është i paqartë, teknikisht i gabuar dhe i papërshtatshëm për natyrën e punimeve që kërkohen;
- Kufizon në mënyrë të drejtpërdrejtë konkurrencën, duke përjashtuar operatorët që zotërojnë makineri standarde të industrisë;
- Siç do të paraqesim më poshtë, ky kriter nuk mbështetet as në paramasën e projektit, as në realitetin teknik, dhe nuk përputhet me asnjë standard profesional ndërtimor.

### **I. ANALIZË TEKNIKE**

*a) Kriteri nuk përputhet me realitetin teknik, sepse:*

Në projektin në fjalë, sipas përshkrimeve të paramasës:

- Kërkohet rrafshim i nenbazës me ngjeshje deri në 30 MN/m<sup>2</sup> në një sipërfaqe të konsiderueshme (Pozicioni 2.2 – mbi 9000 m<sup>2</sup> gjithsej);
- Kërkohet formësim dhe sheshim i rrugës në gjatësi mbi 2000 metra (Pozicionet 1.1);
- Kërkohet mbushje e konsiderueshme me volum prej mbi 1000 m<sup>3</sup> (Pozicioni 3.1) si dhe punime me tampon gëlqeror në trashësi dhe volum të lartë.

Të gjitha këto operacione nuk mund të realizohen nga një makinë për sheshim me peshë maksimale 6 tonë, pasi:

- Makineritë standarde për këtë qëllim janë graderë rrugësh (motor graders), të cilët në minimum peshojnë 10–18 tonë, për të ofruar stabilitetin, fuqinë për nivelizim të saktë dhe saktësi në përpunimin e shtresave.

*b) Egizston një Paqartësi në përkufizimin e llojit të makinerisë*

Specifikimi “makinë për sheshim dhe nivelizim” është:

- I pasaktë – nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për grader, bulldozer, apo një makinë më e vogël ndihmëse;
- Lejon interpretim të lirë nga Autoriteti Kontraktues në fazën e vlerësimit, duke e bërë procesin të pambështetur dhe jo transparent;

- Vendos ofertuesit në pozitë të pabarabartë, pasi disa mund të ofrojnë grader, disa do të përjashtohen për tejkallim peshe, dhe disa mund të përjashtohen për lloj të ndryshëm makinerie.

*c) Pesha maksimale 6 tonë – kufizim absurd dhe jashtë praktikës e aq me pak me rexhistrim validë.*

Në asnjë standard profesional, kombëtar apo ndërkombëtar nuk parashihet përdorimi i një makinerie për nivelizim rrugësh me peshë nën 6 tonë. Ky Kriter:

- Përjashton gjithë graderët standardë nga tenderimi, duke lënë të mundshme vetëm përdorimin e ndonjë makinerie të vogël, e cila nuk është në gjendje të përmbushë detyrat që dalin nga paramasa;
- Për pasojë, projekti nuk do të përfundojë me cilësi teknike të pranueshme nëse përdoret një makinë nën 6 tonë, që është praktikisht e papërdorshme në situatat e përshkruara në projekt.

## **II. ANALIZË LIGJORE DHE PËRPLASJA ME LPP-në**

*a) Neni 7 i LPP – Parimi i trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë*

Kriteri i vendosur:

- Shkel parimin e barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, duke favorizuar vetëm një segment shumë të kufizuar që mund të posedojë pajisje nën 6 tonë;
- Kufizon pjesëmarrjen e operatorëve legjitimë me pajisje teknike standarde;
- Krijon një “treg të mbyllur”, pasi makineritë e kërkuara janë të rralla dhe operatorët që i posedojnë nuk i japin me qira, duke e bërë të pamundur marrjen në shfrytëzim.

*b) Neni 28 i LPP – Specifikimet teknike*

Specifikimi nuk është në përputhje me:

- Objektin dhe nevojën reale të kontratës;
- Standardet dhe praktikatat e zakonshme të industrisë;
- Qartësinë dhe proporcionalitetin, siç kërkohet në këtë nen.

*c) Neni 69 i LPP – Diskriminimi i fshehur përmes kërkesave të pajustificuara*

- Vendosja e kufirit të peshës 6 tonë krijon një pengesë të pajustificuar dhe përjashtuese;
- Ky është diskriminim indirekt, i cili synon – qëllimisht ose jo – përjashtimin e ofertuesve që zotërojnë pajisje të standardit të industrisë.

Autoriteti Kontraktues është shprehur se:

***“Specifikimet përkojnë me terrenin dhe mund të plotësohen edhe përmes marrëveshjeve për shfrytëzim (qira) të makinerisë.”***

Kjo përgjigje është jo bindëse, sepse:

- Në praktikë, **makineritë nën 6 tonë nuk përdoren për nivelizim rrugësh** në projekte të tilla infrastrukturore;
- **Marrja me qira nuk është e mundur**, sepse në tregun aktual, operatori që i posedon ato **nuk i ofron për qira**, dhe për më tepër, **nuk ekziston një flotë e tillë e hapur për qasje të drejtë konkurruese**;
- Krijohet një **favorizim real dhe i padrejtë**, duke përjashtuar ofertues të tjerë që posedojnë grader standard, që është **mjeti adekuat për detyrën e përshkruar**.

Bazuar në analizën e mësipërme, kërkojmë që OSHP:

1. **Të konstatojë se kërkesa për makinë për sheshim dhe nivelizim max 6 tonë – është diskriminuese, e paqartë dhe teknologjikisht e pasaktë;**
2. **Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të heqë ose të riformulojë kriterin**, duke specifikuar qartë që kërkohet grader rrugësh standard me përshkrim dhe peshë reale të industries,



## PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3: “Dron për matje gjeodezike – minimum 1 copë”

### I. NATYRA E PRETENDIMIT

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

**“Dron për matje gjeodezike – minimum 1 copë”**

Ky kriter paraqet një kufizim të pajustificueshëm teknik dhe ligjor, duke:

- Shkelur parimin e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë;
- Favorizuar teknologji specifike dhe duke përjashtuar pajisje standarde ndërkombëtare për matje gjeodezike;
- U imponuar operatorëve një metodë të vetme, që në rrethana të caktuara as nuk është zgjidhja më efikase.

### II. ANALIZË TEKNIKE

*a) Nuk ekziston vetëm një mënyrë për matje gjeodezike*

Teknologjia moderne për matje gjeodezike përfshin:

- Total station (tachymeter)
- GPS gjeodezik (RTK / GNSS)

**Droni nuk është i vetmi instrument**, as më i saktë në të gjitha kushtet, dhe as më praktik në të gjithë terrenin rural (sidomos në fshatra me pengesa të dendura si ndërtime, pemë, linja elektrike)

*b) Nuk ekziston nevojë reale për dron sipas përshkrimit të paramasës*

Asnjë nga pozicionet e paramasës – të cilat përfshijnë:

- Gërmime, rrafshime, formësim nenbazash, mbushje, vendosje tamponi dhe asfaltbetoni, ngritje kapakësh, nivelizime, etj.

**nuk e justifikon kërkesën për përdorim të detyrueshëm të dronit e aq me pak me rexhistrim!**

Shënimi i trases (pozicionet 1.1 të projektit) dhe kontrolli i niveleve janë detyra që në çdo projekt të kësaj natyre:

- **Zakonisht bëhen me total station** që kanë saktësi më të lartë sesa droni dhe nuk varen nga moti, pengesat vizuale apo kufizimet e hapësirës.

*c) Kufizim artificial i konkurrencës – dhe treg i mbyllur*

Kërkesa për dron të domosdoshëm:

- **Përfshihet operatorët që posedojnë pajisje të tjera të standardizuara** si total station, GPS, etj.;
- **Favorizon në mënyrë të nënkuptuar një grup të vogël operatorësh** që posedojnë konkretisht këtë pajisje;
- Në praktikë, **operatorët që kanë dron gjeodezik të certifikuar** për këto punime **nuk e ofrojnë për qira**, duke e bërë të pamundur sigurimin përmes marrëveshjes për shfrytëzim, siç është pretenduar gabimisht nga AK.

### **III. ANALIZË LIGJORE – SHKELJE DIREKTE TË LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK (LPP)**

*Neni 7 – Parimi i trajtimit të barabartë dhe konkurrencës*

Ky kriter:

- E bën **konkurrencën jo të drejtë**, sepse detyron ofertuesit të posedojnë një pajisje specifike (dron), ndërkohë që alternativa të vlefshme përjashtohen;
- **Favorizon padrejtësisht operatorë që mund të kenë lidhje me përpiluesit e dosjes ose që kanë pajisje specifike të njëjtë me përshkrimin e dhënë.**

**Neni 28 – Specifikimet teknike**

Sipas këtij neni:

*“Specifikimet teknike duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk duhet të përshkruajnë teknologji të veçantë që kufizon konkurrencën.”*

Kërkesa për dron:

- Nuk buron nga **nevojë teknike reale e kontratës**, sepse:
  - Punët e kërkuara në paramasë **mund të kryhen me mjete të tjera precize dhe më të zakonshme;**
  - Nuk ka asnjë specifikë që kërkon **fotogrametri ajrore apo modele 3D me re pikash** që janë të domosdoshme vetëm me dron.

#### *Neni 69 – Diskriminimi i fshehur përmes kriterëve të panevojshme*

Duke përcaktuar një mjet të vetëm të pranueshëm për një funksion që ka **shumë zgjidhje teknike**, AK ka krijuar:

- **Diskriminim indirekt teknik;**
- **Parapërdorim të ofertuesve që nuk përdorin këtë metodë**, ndonëse janë të certifikuar dhe të aftë për punën në fjalë.

#### **IV. MUNGESË E PËRGJIGJES SË VEÇANTË NGA AK**

Autoriteti Kontraktues ka dhënë një përgjigje të përgjithshme për të gjitha pretendimet, pa i trajtuar veçmas asnjërin prej tyre. Për më tepër:

- **Nuk ka ofruar asnjë argument profesional apo teknik përse kërkohet vetëm droni e aq me pak me rexhistrim .;**
- **Nuk është trajtuar fakti që matjet në terren mund të bëhen me mjete alternative;**
- **Nuk është dhënë ndonjë arsye logjike apo projektike që e lidh këtë pajisje me përmbushjen e qëllimeve të kontratës.**

Bazuar në sa më sipër, kërkojmë që:

1. **Të konstatohet se kërkesa për “dron për matje gjeodezike – minimum 1 copë” është e pajustificuar teknikisht, kufizuese dhe në kundërshtim me nenet 7, 28 dhe 69 të LPP-së;**
2. **Të urdhërohet Autoriteti Kontraktues të riformulojë kriterin, duke lejuar çdo pajisje të standardizuar për matje gjeodezike (GPS , total station, etj.);**
3. **Ose të hiqet tërësisht ky kriter, për të shmangur diskriminimin e padrejtë dhe për të ruajtur integritetin e procedurës;**



#### **Pretendimi Ankimor numer 4.**

### **I. SHKELJA E QARTË LIGJORE NGA AUTORITETI KONTRAKTUES-KOMUNA FERIZAJ**

Sipas **nenit 108/A, paragrafi 6** i LPP-së:

*"Në rastet kur paraqitet kërkesë për rishqyrtim gjatë afatit të dorëzimit të ofertave, autoriteti kontraktues është i OBLIGUAR të pezullojë aktivitetin përkatës të prokurimit dhe të SHTYJË afatin për dorëzimin e ofertave derisa të trajtohet kërkesa për rishqyrtim."*

Në rastin konkret, autoriteti kontraktues ka pranuar kërkesën tonë më 05.07.2025 dhe ka nxjerrë vendimin më 08.07.2025, pra brenda afatit ligjor. Mirëpo, **përkundër faktit që kërkesa për rishqyrtim ishte aktive dhe brenda afatit të ofertimit**, autoriteti ka dështuar të përmbushë obligimin ligjor për shtyrjen e afatit për dorëzimin e ofertave.

Kjo **mos-shtyrje përbën një shkelje esenciale dhe substanciale** të procedurës, e cila jo vetëm që cenon barazinë e operatorëve ekonomikë, por edhe e bën të pavlefshëm çdo veprim të mëtejshëm të autoritetit kontraktues që rrjedh nga kjo procedurë, përfshirë vetë vendimin për refuzimin e kërkesës sonë.

### **II. MUNGESË ABSOLUTE E PËRPUKTHJES ME PARIMET E TRANSPARENCËS DHE BARAZISË**

Mosveprimi i autoritetit kontraktues bie ndesh me **parimet themelore të prokurimit publik** të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së, e veçanërisht me parimet e:

- **Barazisë në trajtim** (neni 7.1.2)
- **Transparencës dhe integritetit** (neni 7.1.4)
- **Konkurrencës së ndershme** (neni 7.1.5)

Duke mos shtyrë afatin, autoriteti ka krijuar një avantazh të padrejtë për operatorët që nuk janë prekur nga pretendimet tona ligjore dhe ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në **kredibilitetin e garës**, duke e shndërruar një proces që do duhej të ishte i drejtë dhe ligjor në një proces të njollosur nga parregullsi thelbësore.

### III. KËRKESA LIGJORE

Bazuar në sa më sipër, dhe në përputhje me kompetencat e juaja si organ i pavarur mbikëqyrës i sistemit të prokurimit publik, **kërkojmë** që OSHP të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

1. **Të konstatojë se autoriteti kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 108/A të LPP-së duke mos shtyrë afatin e ofertimit.**
2. **Të urdhërojë pezullimin e menjëhershëm të aktivitetit të prokurimit përkatës, në përputhje me nenin 108/A.**
3. **Të obligojë autoritetin kontraktues që të rivendosë procesin në binarë të ligjshmërisë, përfshirë shtyrjen e afatit për dorëzimin e ofertave.**

Me respekt të thellë për misionin e OSHP-së në mbrojtje të konkurrencës së ndershme dhe ligjshmërisë, kërkojmë që të merret:

### V E N D I M

**I APROVOHET** si e bazuar Ankesa e ARSIMI COMPANY SH.P.K.

**II. OBLIGOHET AK** që ti largoj kriteret diskriminuese dhe të zgjas afatin e dorëzimit të ofertave

#### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Demet materiale të shkaktuara gjër me tani kapin shumën afër 20,000.00 €**

**blerjen e makinerive për të plotësuar kriteret e dosjes së tenderit.**

#### 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.